



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E BUXHETIT

U D H Ë Z I M

NR. 5, DATË 8.4.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT FINANCIAR TË VLERËS SË PLOTË TË PROJEKTIT NË
PËRPUTHJE ME SPECIFIKAT E SEKTORIT, MBI BAZËN E TË CILIT PËRCAKTOHET
MËNYRA DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË INVESTIMIT PUBLIK**

Në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", Ministri i Financave,

U D H Ë Z O N :

1. Çdo propozim për projekt investimesh publike, që ka një vlerë të plotë mbi kufirin e përcaktuar sipas lidhjes Nr. 1, duhet t'i nënshtrohet një procesi të plotë vlerësimi, përpara fillimit të procesit buxhetor.
2. Udhëzimi Nr. 4, datë 20.02.2023 "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik", shfuqizohet.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.



Tabela 1: Klasifikimi i Projekteve Strategjike

SEKTORI	PËRSHKRIMI	NËNSEKTORI	VLERA
Digjital	Infrastruktura Digjitale, i referohet teknologjive digjitale, të cilat ofrojnë bazën për teknologjinë dhe operacionet e informacionit të një njësie organizative. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Infrastrukturës Digjitale të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Ndërlidhja me Bazë të Gjerë	Mbi 700,000,000 Lekë
		Infrastruktura e-GOV	
		Sisteme informacioni	
		Platformat e Inovacionit	
Zhvillimi Ekonomik	Zhvillimi Ekonomik, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim të përmirësojnë mirëqenien ekonomike dhe cilësinë e jetës së burrave dhe grave të komunitetit në vend. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Agrikultura	Mbi 700,000,000 Lekë
		Zhvillimi i Biznesit	
		Infrastruktura Bregdetare dhe Detare	
		Sipërmarrja	
		Industria	
		Zhvillimi Rajonal	
		Turizmi	
Energjia	Energjia, i referohet aktiviteteve ekonomike me impakt në prodhimin dhe shitjen e energjisë, përfshirë nxjerrjen e karburanteve, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Energjisë të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Efienca e Energjisë	Mbi 1,200,000,000 Lekë
		Prodhimi I Energjisë	
		Transmetimi I Energjisë	
		Gazi	
		Nafta	
		Energjia e Rinovueshme	
Mjedisi	Mjedisi, i referohet aktiviteteve ekonomike të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Mjedisit të gjitha Projektet e Investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Menaxhimi I Fatkeqësive	Mbi 700,000,000 Lekë
		Mbrojtja nga Përmytjet	
		Zhvillimi I Qëndrueshëm	
		Menaxhimi I Mbetjeve, Landfillet	
		Furnizimi me Ujë	
Social	Sektori Social, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim reduktimin e shtrirjes së varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së burrave dhe grave të në vend si dhe adresimin e pabarazive gjinore në përgjithësi. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit Social të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Kultura	Mbi 700,000,000 Lekë
		Edukimi dhe Sportet	
		Shëndetësia	
		Strehimi	
		Siguria e Brendshme	
		Drejtësia	
		Mbrojtja Sociale	
Transporti	Transporti, i referohet aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim zhvillimin apo përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të transportit të mallrave dhe / ose qytetarëve nëpërmjet tokës, ujërave dhe ajrit. Do të konsiderohen si pjesë e të Transportit të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Transporti Ajror	Mbi 2,500,000,000 Lekë
		Transporti në Ujërat e Brendshme, Portet	
		Transporti Hekurudhor	
		Transporti Rrugor	